**LIGJ**
**Nr.9623, datë 16.10.2006**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE KUNDËR DOPINGUT NË SPORT, 2005**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5097, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

## KONVENTA NDËRKOMBËTARE

KUNDËR DOPINGUT NË SPORT, 2005
Paris, 19 tetor 2005

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Kulturore, Shkencore dhe Arsimore e Kombeve të Bashkuara, që këtu quhet "UNESCO", që mbahet në Paris nga 3 deri 21 tetor 2005, në sesionin e saj të 33-të:

- *duke pasur parasysh* se qëllimi i UNESCO-s është të kontribuojë për paqen dhe sigurinë duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet kombeve me anë të arsimit, shkencës dhe kulturës;
- *duke iu referuar* instrumenteve ekzistuese ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut;
- *duke ditur* rezolutën 58/5 të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 3 nëntor 2003, në lidhje me sportet, si një mjet për nxitjen e arsimit, shëndetit, zhvillimit dhe paqes, siç është paragrafi 7 i saj;
- *të ndërgjegjshëm* se sporti duhet të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit, në edukimin moral, kulturor dhe fizik, dhe në nxitjen e mirëkuptimit ndërkombëtar dhe paqes;
- *duke vënë re* nevojën për të inkurajuar dhe bashkërenduar bashkëpunimin ndërkombëtar drejt eliminimit të dopingut në sport;
- *e shqetësuar* nga përdorimi i dopingut nga atletët në sport dhe pasojat e tij për shëndetin e tyre, principin e lojës së drejtë, eliminimin e mashtrimit dhe të ardhmen në sport;
- *duke ditur* se dopingu vë në rrezik principet etike dhe vlerat edukative që mishërohen në Kartën Ndërkombëtare të Edukimit Fizik dhe Sportit e UNESCO-s dhe në Kartën Olimpike;
- *duke rikujtuar* se Konventa Antidoping dhe protokolli i saj shtesë, i miratuar në kuadrin e Këshillit të Europës, janë mjetet e së drejtës ndërkombëtare publike që janë në origjinën e politikave të brendshme antidoping dhe të bashkëpunimit ndërqeveritar;
- *duke rikujtuar* rekomandimet mbi dopingun, të miratuara nga Konferenca Ndërkombëtare e dytë, e tretë dhe e katërt e ministrave dhe zyrtarëve të lartë përgjegjës për edukimin fizik dhe sportin e organizuar nga UNESCO në Moskë (1988), Punta del Este (1999) dhe Athinë (2004) dhe 32C/Rezoluta 9 e miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në sesionin e saj të 32-të (2003);
- *duke pasur parasysh* Kodin Botëror Antidoping, i miratuar nga Agjencia Botërore Antidoping në Konferencën Botërore mbi dopingun në sport, Kopenhagen, 5 mars 2003 dhe Deklaratën e Kopenhagenit mbi antidopingun në sport;

- *duke ditur* gjithashtu edhe influencën që atletët elitarë kanë te rinia;

- *të ndërgjegjshëm* për nevojën në vazhdim për të zhvilluar dhe nxitur kërkimin me synimin e përmirësimit të zbulimit të dopingut dhe një të kuptuar më të mirë të faktorëve që kanë efekt mbi përdorimin me qëllim që strategjitë parandaluese të jenë me efekt të lartë;

- *të ndërgjegjshëm* gjithashtu edhe për rëndësinë e edukimit në vazhdim të atletëve, personelit në mbështetje të atletëve dhe publikut të gjerë në parandalimin e dopingut;

- *duke ditur* nevojën për ndërtimin e kapaciteteve të shteteve Palë për zbatimin e programeve antidoping;

- *të ndërgjegjshëm* se organet publike dhe organizatat përgjegjëse për sportin kanë përgjegjësi plotësuese për parandalimin dhe luftën kundër dopingut në sport, me qëllim që të arrihet zhvillimi i duhur i ngjarjeve sportive, mbi bazën e principit të lojës së drejtë, dhe të mbrohet shëndeti i atyre që marrin pjesë në to;

- *duke njohur* se këto autoritete dhe organizata duhet të punojnë së bashku për këto qëllime, duke siguruar shkallën më të lartë të pavarësisë dhe transparencë në të gjitha shkallët e duhura;

- *të vendosur* për të ndërmarrë veprim më të fuqishëm bashkëpunues, që synon eliminimin e dopingut në sport;

- *duke njohur* që eliminimi i dopingut në sport pjesërisht varet nga harmonizimi progresiv i standardeve dhe praktikave antidoping në sporte dhe bashkëpunimi në nivelet kombëtare dhe globale,

miraton këtë Konventë në ditën e nëntëmbëdhjetë të tetorit 2005.

## I. FUSHA E ZBATIMIT

### Neni 1
### **Qëllimi i Konventës**

Qëllimi i kësaj Konvente, në kuadrin e strategjisë dhe programeve të aktiviteteve të UNESCO-s në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, është të nxisë parandalimin dhe luftën kundër dopingut në sport, me synim eliminimin e tij.

### Neni 2
### **Përkufizime**

Këto përkufizime duhet të kuptohen në kontekstin e Kodit Botëror Andidoping. Megjithatë, në rast konflikti, dispozitat e Konventës janë prioritare.

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “Laboratorë të akreditуar për kontrollin e dopingut” janë laboratorët që janë akreditуar nga Agjencia Botërore e Antidopingut.

2. “Organizatë antidoping” është një subjekt që është përgjegjës për miratimin e rregullave për fillimin, zbatimin ose ekzekutimin e çdo pjese të procesit të kontrollit të dopingut. Kjo përfshin, për shembull, Komitetin Ndërkombëtar Olimpik, Komitetin Ndërkombëtar Paraolimpik ose organizata në ngjarje madhore që kryejnë analiza në ngjarjet e tyre, Agjencia Botërore Antidoping, federatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare antidoping.

3. “Shkelja e rregullit të antidopingut” në sport është një ose disa nga të mëposhtmet:

a) prania e substancës së ndaluar ose metaboliteve apo shenjave të saj në kampione prej trupit të atletit;

b) përdorimi ose tentativa për përdorimin e një substance të ndaluar ose e një metode të ndaluar;

c) refuzimi ose mosparaqitja pa pasur ndonjë justifikim bindës për mbledhjen e kampioneve pas njoftimit sipas autorizimit në pajtim me rregullat antidoping apo largimi në një mënyrë tjetër nga mbledhja e kampioneve;

d) shkelja e kërkesave të zbatueshme në lidhje me gatishmërinë e atletëve për testet jashtë gare, duke përfshirë mosdhënien e informacionit për vendndodhjen dhe moskryerjen e testeve që janë shpallur bazuar në rregulla të arsyeshme;

e) ndryshimi ose përpjekja për të ndryshuar ndonjë pjesë të kontrollit të dopingut;

f) posedimi i substancave ose metodave të ndaluara;

g) trafikimi i ndonjë substance të ndaluar ose një metode të ndaluar;

h) administrimi ose përpjekja për të administruar një substancë të ndaluar ose një metodë të ndaluar nga një atlet, apo ndihma, inkurajimi mbështetja, nxitja, fshehja apo ndonjë lloj tjetër bashkëpunimi në lidhje me shkeljen e një rregulli antidoping apo përpjekjen për një shkelje të tillë.

4. “Atlet” për qëllimet e kontrollit të dopingut, është çdo person që merr pjesë në sport në nivel ndërkombëtar ose kombëtar sipas përkufizimit nga çdo organizatë kombëtare antidoping dhe pranuar nga Shtetet Palë dhe çdo person tjetër që merr pjesë në sport apo ngjarje në një nivel më të ulët të pranuar nga Shtetet Palë. Për qëllimet e edukimit dhe programeve të trajnimit, “atlet” është çdo person që merr pjesë në sport nën autoritetin e një organizate sportive.

5. “Personel mbështetës i atletit” është çdo stërvitës, trajner, menaxher, agjent, personel ekipi, zyrtar, personel mjekësor ose paramjekësor, që punon me ose trajton atletët që marrin pjesë ose përgatiten për garë sportive.

6. “Kod” është Kodi Botëror Antidoping i miratuar nga Agjencia Botërore Antidoping më 5 mars 2003 në Kopenhagen, i cili është bashkëngjitur si shtesa 1 e kësaj Konvente.

7. “Garë” është një garë, ndeshje, lojë e vetme ose një takim i vetëm atletik.

8. “Kontroll dopingu” është procesi që përfshin planifikimin e shpërndarjes së testit, mbledhjen dhe trajtimin e kampioneve, analizën laboratorike, menaxhimin e rezultateve, seancat dhe ankimet.

9. “Doping në sport” është ndodhia e një shkeljeje të një rregulli antidoping.

10. “Ekipet e autorizuara rregullisht për kontrollin e dopingut” janë ekipet që kontrollojnë dopingun nën autoritetin e organizatave ndërkombëtare ose kombëtare antidoping.

11. “Testim gjatë garës”, për qëllimet e diferencimit ndërmjet testimit gjatë garës dhe jashtë garës, nëse nuk parashikohet ndryshe në rregullat e një federate ndërkombëtare apo të një organizate tjetër përkatëse antidoping, është një test ku atleti zgjidhet për t’u testuar në lidhje me një garë të caktuar.

12. “Standardi ndërkombëtar për laboratorët” është standardi që është bashkëngjitur shtuar si shtesa 2 në këtë Konventë.

13. “Standardi ndërkombëtar për testim” është standardi që është bashkëngjitur si shtesa 3 në këtë Konventë.

14. “Pa njoftim paraprak” është një kontroll dopingu që ndodh pa ndonjë njoftim paraprak për atletin dhe ku atleti mbahet vazhdimisht nën mbikëqyrje nga momenti i njoftimit nëpërmjet dhënies së kampioneve.

15. “Lëvizje olimpike” janë të gjithë ata që bien dakord të drejtohen nga Karta Olimpike dhe që njohin autoritetin e Komitetit Ndërkombëtar Olimpik, veçanërisht federatat ndërkombëtare të sporteve në programin e Lojërave Olimpike, komitetet kombëtare olimpike, komitetet organizatore të lojërave olimpike, atletët, gjyqtarët dhe arbitrat, shoqatat dhe klubet, si dhe organizatat dhe institucionet e njohura nga Komiteti Ndërkombëtar Olimpik.

16. “Kontroll i dopingut jashtë gare” është çdo kontroll për doping, i cili nuk kryhet gjatë garës.

17. “Listë e ndaluar” është lista që ndodhet në aneksin I të kësaj Konvente, e cila identifikon substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara.

18. “Metodë e ndaluar” është çdo metodë që përshkruhet e tillë në listën e ndaluar, e cila ndodhet në aneksin I të kësaj Konvente.

19. “Substancë e ndaluar” është çdo substancë që përshkruhet e tillë në listën e ndaluar, që ndodhet në aneksin I të kësaj Konvente.

20. “Organizatë sportive” është çdo organizatë që shërben si organ vendimmarrës në një ngjarje për një ose disa sporte.

21. “Standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapik” janë ato standarde që ndodhen në aneksin II të kësaj Konvente.

22. “Testim” janë ato pjesë të procesit të kontrollit të dopingut që përfshijnë planifikimin e shpërndarjes së testit, mbledhjen e kampioneve, trajtimin e kampioneve dhe transportin e kampioneve te laboratori.

23. “Përjashtimi për përdorim terapik” është një përjashtim i lejuar në pajtim me standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapik.

24. “Përdorim” është zbatimi, gëlltitja, injektimi, ose konsumimi me çfarëdolloj mjeti i një

prej substancave të ndaluara ose metodave të ndaluara.

25. “Agjencia Botërore Antidoping” (WADA) është organizata e quajtur kështu e themeluar në bazë të ligjit sviceran më 10 nëntor 1999.

Neni 3

**Mjetet për arritjen e qëllimit të Konventës**

Me qëllim që të arrihet qëllimi i Konventës, Shtetet Palë ndërmarrin:

a) të miratojnë masa të përshtatshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, që janë në pajtim me parimet e Kodit;

b) të inkurajojnë të gjitha format e bashkëpunimit ndërkombëtar, që synojnë mbrojtjen e atletëve dhe etikës në sport dhe bërjen të ditur të kërkimeve;

c) të mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet Shteteve Palë dhe organizatave udhëheqëse në luftën kundër dopingut në sport, veçanërisht me Agjencinë Botërore Antidoping.

Neni 4

**Raporti i Konventës me Kodin**

1. Me qëllim që të bashkërendohet zbatimi i luftës kundër dopingut në sport në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Shtetet Palë u nënshtrohen parimeve të Kodit si bazë për masat e parashikuara në nenin 5 të kësaj Konvente. Asgjë në këtë Konventë nuk i pengon Palët të marrim masa shtesë në plotësim të Kodit.

2. Kodi dhe varianti më i fundit i shtesave 2 dhe 3 riprodhohen për qëllime informimi dhe nuk përbëjnë pjesë integrale të kësaj Konvente. Shtesat si të tilla nuk krijojnë ndonjë detyrim urdhërues në bazë të së drejtës ndërkombëtare për Shtetet Palë.

3. Anekset janë pjesë integrale e kësaj Konvente.

Neni 5

**Masat për arritjen e objektivave të Konventës**

Për përmbushjen e detyrimeve që parashikohen në këtë Konventë, secili Shtet Palë merr përsipër të marrë masa të përshtatshme. Këto masa mund të përfshijnë legjislacionin, rregulloret, politikat ose praktikat administrative.

Neni 6

**Raporti me instrumentet e tjera ndërkombëtare**

Kjo Konventë nuk i ndryshon të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Palë që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura më parë dhe që përputhen me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente. Kjo nuk cenon gëzimin nga Shtetet e tjera Palë të të drejtave të tyre ose përmbushjen e detyrimeve në bazë të kësaj Konvente.

## II. AKTIVITETET ANTIDOPING NË NIVEL KOMBËTAR

Neni 7

**Bashkërendimi i brendshëm**

Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e kësaj Konvente, veçanërisht nëpërmjet bashkërendimit të brendshëm. Për të përmbushur detyrimet e tyre në bazë të kësaj Konvente, Shtetet Palë mund të mbështeten në organizatat antidoping, si dhe në autoritetet dhe organizatat sportive.

Neni 8

**Kufizimi i pranisë dhe përdorimit në sport të substancave dhe metodave të ndaluara**

1. Shtetet Palë, sipas rastit, marrin masa për kufizimin e pranisë së substancave dhe metodave të ndaluara me qëllim që të kufizohet përdorimi i tyre në sporte nga atletët, përveç rasteve të përjashtimit për përdorim terapeutik. Këto përfshijnë masat kundër trafikimit te atletët dhe, për këtë qëllim, masat për të kontrolluar prodhimin, lëvizjen, importin, shpërndarjen dhe shitjen.

2. Shtetet Palë miratojnë ose nxisin, sipas rastit, subjektet përkatëse brenda juridiksionit të tyre për të marrë masa për të parandaluar dhe kufizuar përdorimin dhe zotërimin e substancave dhe metodave të ndaluara nga atletët në sport, përveç kur përdorimi bazohet në një përjashtim për përdorim terapeutik.

3. Asnjë masë e marrë në bazë të kësaj Konvente nuk e pengon praninë për qëllimet e legjitimuara të substancave ose metodave që në çdo rast tjetër ndalohen ose kontrollohen në sport.

Neni 9

**Masat kundër personelit mbështetës të atletëve**

Shtetet Palë marrin vetë masa ose nxisin organizatat sportive dhe organizatat antidoping për marrjen e masave, duke përfshirë sanksionet dhe dënimet, kundër personelit në mbështetje të atletëve që bën shkelje të rregullave antidoping ose vepra të tjera penale që lidhen me dopingun në sport.

Neni 10

**Shtesat ushqimore**

Shtetet Palë, sipas rastit, inkurajojnë prodhuesit dhe shpërndarësit e shtesave ushqimore të vendosin praktikat më të mira në tregtimin dhe shpërndarjen e shtesave ushqimore, duke përfshirë informacionin për përbërjen e tyre analitike dhe garancinë cilësore.

Neni 11

**Masat financiare**

Shtetet Palë, sipas rastit:

a) japin fonde brenda buxheteve të tyre përkatëse në mbështetje të një programi kombëtar testimi në të gjitha sportet ose ndihmojnë organizatat sportive dhe organizatat antidoping në financimin e kontrolleve të dopingut nëpërmjet subvencioneve ose granteve të drejtpërdrejta, ose duke njohur shpenzimet e këtyre kontrolleve në caktimin e subvencioneve ose granteve të përgjithshme që u jepen këtyre organizatave;

b) marrin masa për mosdhënien e mbështetjes financiare në lidhje me sportin për ata atletë individualë ose personel në mbështetje të atletëve, të cilët janë pezulluar për shkak të shkeljes së një rregulli antidoping gjatë periudhës së pezullimit të tyre;

c) nuk u jep mbështetjen financiare ose tjetër në lidhje me sportin organizatave sportive ose organizatave antidoping që nuk përmbushin Kodin ose rregullat e zbatueshme antidoping të miratuara në pajtim me Kodin.

Neni 12

**Masat për lehtësimin e kontrollit të dopingut**

Shtetet Palë, sipas rastit:

a) nxisin dhe lehtësojnë zbatimin nga organizatat sportive dhe organizatat antidoping brenda juridiksionit të tyre të kontrolleve të dopingut në një mënyrë që përputhet me Kodin, duke përfshirë mosbërjen e njoftimit paraprak, testimet gjatë dhe jashtë garës;

b) nxisin dhe lehtësojnë negocimin nga organizatat sportive dhe organizatat antidoping të marrëveshjeve që u lejojnë anëtarëve të tyre të testohen nga ekipet e kontrollit të dopingut të autorizuara rregullisht nga vende të tjera;

c) marrin përsipër të ndihmojnë organizatat sportive dhe organizatat antidoping brenda juridiksionit të tyre të kenë mundësinë te një laborator i akredituar për kontrollin e dopingut për qëllimet e analizave të kontrollit të dopingut.

## III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

### Neni 13
### Bashkëpunimi ndërmjet organizatave antidoping dhe organizatave sportive

Shtetet Palë inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet organizatave antidoping, organeve publike dhe organizatave sportive brenda juridiksionit të tyre dhe atyre brenda juridiksionit të Shteteve të tjera Palë, me qëllim që të arrihet qëllimi i kësaj Konvente në nivel ndërkombëtar.

### Neni 14
### Mbështetja e misionit të Agjencisë Botërore Antidoping

Shtetet Palë marrin përsipër të mbështesin misionin e rëndësishëm të Agjencisë Botërore Antidoping në luftën ndërkombëtare kundër dopingut.

### Neni 15
### Financimi i barabartë i Agjencisë Botërore Antidoping

Shtetet Palë mbështesin parimin e financimit të barabartë të buxhetit bazë vjetor të aprovuar të Agjencisë Botërore Antidoping nga organet publike dhe lëvizja olimpike.

### Neni 16
### Bashkëpunimi ndërkombëtar në kontrollin e dopingut

Duke ditur që lufta kundër dopingut në sport mund të jetë e efektshme kur atletët mund të testohen pa u njoftuar paraprakisht dhe kampionet të transportohen në kohën e duhur në laboratorë për analiza, Shtetet Palë, sipas rastit dhe në pajtim me ligjin dhe procedurat e brendshme:

a) lehtësojnë detyrën e Agjencisë Botërore Antidoping dhe të organizatave antidoping që operojnë në pajtim me Kodin, duke iu nënshtruar rregullave të vendit pritës përkatës në kryerjen e kontrolleve të dopingut brenda dhe jashtë garës te atletët e tyre, pavarësisht nëse ata janë në territorin e tyre apo gjetkë;

b) lehtësojnë lëvizjen në kohë të ekipeve të kontrollit të dopingut të autorizuara rregullisht në kalimin e kufijve gjatë kryerjes së aktiviteteve për kontrollin e dopingut;

c) bashkëpunojnë për të shpejtuar dërgimin ose kalimin e kufirit të kampioneve, në mënyrë të tillë që të ruajnë sigurinë dhe integritetin e tyre;

d) ndihmojnë në bashkërendimin ndërkombëtar të kontrolleve të dopingut nga organizata të ndryshme antidoping dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim me Agjencinë Botërore Antidoping;

e) nxisin bashkëpunimin ndërmjet laboratorëve të kontrollit të dopingut brenda juridiksionit të tyre dhe ata brenda juridiksionit të Shteteve të tjera Palë. Veçanërisht, Shtetet Palë me laboratorë të akredituar për kontrollin e dopingut duhet të inkurajojnë laboratorët brenda juridiksionit të tyre të ndihmojnë Shtetet e tjera Palë t'u mundësojnë atyre të fitojnë eksperiencën, aftësitë dhe teknikat e nevojshme për krijimin e laboratorëve të tyre, nëse ata duan ta bëjnë këtë;

f) inkurajojnë dhe mbështesin masat reciproke të testimit ndërmjet organizatave të caktuara antidoping, në pajtim me Kodin;

g) njohin reciprokisht procedurat e kontrollit të dopingut dhe menaxhimin e rezultateve të testit, duke përfshirë sanksionet sportive të tyre, të çdo organizate antidoping që është në pajtim me Kodin.

### Neni 17
### Fondi vullnetar

1. Themelohet një “Fond për eliminimin e dopingut në sport”, që këtu quhet “Fondi vullnetar”. Fondi vullnetar përbëhet nga fonde në besim të krijuara në pajtim me rregullat financiare të UNESCO-s. Të gjitha kontributet nga Shtetet Palë dhe aktorë të tjerë janë vullnetare.

2. Burimet e fondit vullnetar përbëhen nga:

a) kontributet e bëra nga Shtetet Palë;

b) kontributet, dhuratat, trashëgimitë, që mund të bëhen nga:

i) shtete të tjera;

ii) organizata ose programe të sistemit të Kombeve të Bashkuara, sidomos Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin, si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare;

iii) subjekte publike ose private, ose individë;

c) të gjitha interesat e maturuara nga burimet e fondit vullnetar;

d) fondet e krijuara nga arkëtimet dhe faturat nga aktivitetet e organizuara në favor të fondit vullnetar;

e) çdo burim tjetër i autorizuar nga rregulloret e fondit vullnetar, të hartuara nga Konferenca e Palëve.

3. Kontributet në fondin vullnetar nga Shtetet Palë nuk konsiderohen të zëvendësojnë detyrimet e Shteteve Palë për të paguar pjesën e tyre në buxhetin vjetor të Agjencisë Botërore Antidoping.

Neni 18

**Përdorimi dhe administrimi i fondit vullnetar**

Burimet në fondin vullnetar caktohen nga Konferenca e Palëve për financimin e aktiviteteve të miratuara prej saj, sidomos për të asistuar Shtetet Palë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve antidoping, në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente, duke marrë parasysh qëllimet e Agjencisë Botërore Antidoping dhe mund të shërbejnë për të mbuluar shpenzimet funksionale të kësaj Konvente. Kontributeve që i janë dhënë fondit vullnetar nuk u vihet asnjë kusht politik, ekonomik apo tjetër.

## IV. EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Neni 19

**Parime të përgjithshme për edukimin dhe trajnimin**

1. Shtetet Palë marrin përsipër, me mjetet e tyre, të mbështesin, hartojnë ose zbatojnë programe edukative dhe trajnuese mbi antidopingun. Për komunitetin sportiv në përgjithësi, këto programe duhet të synojnë të japin një informacion të fundit dhe të saktë mbi:

a) dëmet e dopingut për vlerat etike të sportit;

b) pasojat shëndetësore të dopingut.

2. Për atletët dhe personelin në mbështetje të atletëve, sidomos në trajnimin e tyre fillestar, programet edukative dhe trajnuese, përveç sa më sipër, duhet të synojnë të japin një informacion të fundit dhe të saktë për:

a) procedurat e kontrollit të dopingut;

b) të drejtat dhe përgjegjësitë e atletëve në lidhje me antidopingun, duke përfshirë informacion rreth Kodit dhe politikat antidoping të të gjitha organizatave përkatëse sportive dhe antidoping. Ky informacion përfshin edhe pasojat e kryerjes së shkeljes së rregullave antidoping;

c) listën e substancave dhe metodave të ndaluara dhe përjashtimet për përdorim terapeutik;

d) shtesat ushqimore.

Neni 20

**Kodet profesionale të sjelljes**

Shtetet Palë inkurajojnë shoqatat dhe institucionet kompetente profesionale për të zhvilluar dhe zbatuar kodet e përshtatshme të sjelljes, praktikës së mirë dhe etikës në lidhje me antidopingun në sport që përputhen me Kodin.

Neni 21
**Përfshirja e atletëve dhe personelit në mbështetje të atletëve**

Shtetet Palë nxisin dhe mbështesin me mjetet e tyre pjesëmarrjen aktive të atletëve dhe personelit në mbështetje të atletëve në të gjitha aspektet e punës antidoping të organizatave sportive dhe të tjera përkatëse, dhe i inkurajon organizatat sportive brenda juridiksionit të tyre të bëjnë të njëjtën gjë.

Neni 22
**Organizatat sportive, edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm antidoping**

Shtetet Palë inkurajojnë organizatat sportive dhe organizatat antidoping të zbatojnë programe të vazhdueshme edukative dhe trajnuese për të gjithë atletët dhe personelin në mbështetje të atletëve për çështjet e përcaktuara në nenin 19.

Neni 23
**Bashkëpunimi në edukim dhe trajnim**

Shtetet Palë bashkëpunojnë reciprokisht dhe me organizatat përkatëse, sipas rastit, për shkëmbimin e informacionit, ekspertizës dhe eksperiencës mbi programet e efektshme antidoping.

V. KËRKIMET

Neni 24
**Nxitja e kërkimeve antidoping**

Shtetet Palë marrin përsipër, me mjetet e tyre, të inkurajojnë dhe nxisin kërkimet antidoping në bashkëpunim me organizatat sportive dhe të tjera përkatëse mbi:

a) metodat e parandalimit dhe të zbulimit, aspekte të sjelljes dhe shoqërore, dhe pasojat shëndetësore të dopingut;

b) mënyrat dhe mjetet e hartimit të programeve të bazuara shkencërisht fiziologjikë dhe psikologjikë duke respektuar integritetin e personit;

c) përdorimin e të gjitha substancave dhe metodave të njohura që kanë rezultuar nga zhvillimet shkencore.

Neni 25
**Natyra e kërkimeve antidoping**

Gjatë nxitjes së kërkimeve antidoping, sipas parashikimit të nenit 24, Shtetet Palë sigurojnë që këto kërkime:

a) të përputhen me praktikat etike të njohura ndërkombëtarisht;

b) të mënjanojnë ofrimin e substancave dhe metodave të ndaluara tek atletët;

c) të ndërmerren vetëm pas marrjes së masave të përshtatshme, me qëllim që të parandalohet keqpërdorimi apo zbatimi për dopingun i rezultateve të kërkimeve antidoping.

Neni 26
**Shkëmbimi i rezultateve mbi kërkimet antidoping**

Në pajtim me ligjin e brendshëm dhe ndërkombëtar, Shtetet Palë, sipas rastit, shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve antidoping të kryera me Shtetet e tjera Palë dhe me Agjencinë Botërore Antidoping.

Neni 27
**Kërkimet e sportit shkencor**

Shtetet Palë inkurajojnë:

a) anëtarët e komuniteteve shkencore dhe mjekësore të kryejnë kërkime në shkencën e sportit në pajtim me parimet e Kodit;

b) organizatat sportive dhe personelin në mbështetje të atletëve brenda juridiksionit të tyre të zbatojnë kërkime në shkencën e sportit që përputhen me parimet e Kodit.

## VI. MONITORIMI I KONVENTËS

Neni 28
**Konferenca e Palëve**

1. Themelohet Konferenca e Palëve. Konferenca e Palëve është organi sovran i kësaj Konvente.

2. Konferenca e Palëve mblidhet në sesione të zakonshme, parimisht, një herë në dy vjet. Ajo mund të mblidhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse ajo vendos kështu ose me kërkesën e të paktën një të tretës së Shteteve Palë.

3. Secili Shtet Palë ka një votë në Konferencën e Palëve.

4. Konferenca e Palëve miraton rregulloren e vet procedurale.

Neni 29
**Organizata këshillimore dhe vëzhguesit në Konferencën e Palëve**

Agjencia Botërore Antidoping ftohet si organizatë këshillimore në Konferencën e Palëve. Komiteti Ndërkombëtar Olimpik, Komiteti Ndërkombëtar Paraolimpik, Këshilli i Europës dhe Komiteti Ndërqeveritar për Edukimin Fizik dhe Sportin (CIGEPS) ftohen si vëzhgues. Konferenca e Palëve mund të vendosë të ftojë organizata të tjera përkatëse si vëzhguese.

Neni 30
**Funksionet e Konferencës së Palëve**

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e kësaj Konvente, funksionet e Konferencës së Palëve janë:

a) promovimi i qëllimit të kësaj Konvente;

b) diskutimi i raportit me Agjencinë Botërore të Antidopingut dhe studimi i mekanizmave për financimin e buxhetit themelor vjetor të Agjencisë. Shtetet jopalë mund të ftohen në diskutim;

c) miratimi i një plani për përdorimin e burimeve të fondit vullnetar, në pajtim me nenin 18;

d) shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga Shtetet Palë në pajtim me nenin 31;

e) shqyrtimi i vazhdueshëm i monitorimit të respektimit të kësaj Konvente në përgjigje të sistemeve antidoping, në pajtim me nenin 31. Çdo mekanizëm ose masë monitorimi që tejkalon nenin 31, financohet nga fondi vullnetar i krijuar në pajtim me nenin 17;

f) shqyrtimi i projektndryshimeve të Konventës për miratim;

g) shqyrtimi për t'u aprovuar, në pajtim me nenin 34 të Konventës, i ndryshimeve në listën e ndaluar dhe standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik i miratuar nga Agjencia Botërore Antidoping;

h) përcaktimi dhe zbatimi i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Palë dhe Agjencisë Botërore Antidoping në kuadrin e kësaj Konvente;

i) kërkimi i një raporti nga Agjencia Botërore Antidoping mbi zbatimin e Kodit për shqyrtim në secilin nga sesionet e saj.

2. Konferenca e Palëve, në përmbushje të funksioneve të saj, mund të bashkëpunojë me organe të tjera ndërqeveritare.

Neni 31

**Raportet kombëtare në Konferencën e Palëve**

Shtetet Palë i paraqesin në çdo dy vjet Konferencës së Palëve, nëpërmjet Sekretariatit, në një nga gjuhët zyrtare të UNESCO-s, të gjithë informacionin përkatës në lidhje me masat e marra prej tyre për qëllimet e respektimit të dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 32

**Sekretariati i Konferencës së Palëve**

1. Sekretariati i Konferencës së Palëve sigurohet nga Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

2. Me kërkesë të Konferencës së Palëve, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s i përdor në masën më të madhe të mundur shërbimet e Agjencisë Botërore Antidoping me kushtet e aprovuara nga Konferenca e Palëve.

3. Shpenzimet funksionale në lidhje me Konventën financohen nga buxheti i zakonshëm i UNESCO-s brenda burimeve ekzistuese në një nivel të përshtatshëm, fondi vullnetar i krijuar në bazë të nenit 17 ose një kombinim i tyre, siç vendoset në çdo dy vjet.

4. Sekretariati përgatit dokumentacionin e Konferencës së Palëve, si dhe projektaxhendën e mbledhjeve të saj, dhe siguron zbatimin e vendimeve.

Neni 33

**Ndryshimet**

1. Secili Shtet Palë, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s, mund të propozojë ndryshime për këtë Konventë. Drejtori i Përgjithshëm e qarkullon këtë njoftim te të gjitha Shtetet Palë. Nëse brenda gjashtë muajsh nga data e qarkullimit të njoftimit, e jep pëlqimin të paktën gjysma e shteteve anëtare, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në sesionin tjetër të Konferencës së Palëve.

2. Ndryshimet miratohen nga Konferenca e Palëve me një shumicë prej dy të tretash të Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë.

3. Pas miratimit, ndryshimet e Konventës u paraqiten për ratifikim, pranim, aprovim ose aderim Shteteve Palë.

4. Në lidhje me Shtetet Palë që kanë ratifikuar, pranuar, aprovuar ose aderuar në to, ndryshimet e kësaj Konvente hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni nga dy të tretat e Shteteve Palë. Pas kësaj, për çdo Shtet Palë që ratifikon, pranon, aprovon ose aderon në një ndryshim, ky ndryshim hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga ky Shtet Palë i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit.

5. Një Shtet që bëhet Palë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, nëse nuk shpreh një qëllim tjetër, konsiderohet:

a) Palë në Konventë me ndryshimet përkatëse;

b) Palë në Konventën e pandryshuar në lidhje me çdo Shtet Palë që nuk u nënshtrohet ndryshimeve.

Neni 34

**Procedura e veçantë e ndryshimeve për anekset e Konventës**

1. Nëse Agjencia Botërore Antidoping ndryshon listën e ndaluar apo standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik, ajo njofton Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s për këto ndryshime nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asaj/atij. Drejtori i Përgjithshëm informon menjëherë për këto ndryshime si ndryshime të propozuara për anekset përkatëse të kësaj Konvente të gjitha Shtetet Palë. Ndryshimet e anekseve aprovohen nga Konferenca e Palëve në një nga sesionet e saj ose nëpërmjet konsultimeve me shkrim.

2. Shtetet Palë kanë 45 ditë nga njoftimi i Drejtorit të Përgjithshëm, brenda të cilave ato shprehin kundërshtimin e tyre për ndryshimin e propozuar me shkrim, në rastin e konsultimit me shkrim, te Drejtori i Përgjithshëm ose në një sesion të Konferencës së Palëve. Nëse nuk shprehin

kundërshtim dy të tretat e Palëve, ndryshimi i propozuar konsiderohet të aprovohet nga Konferenca e Palëve.

3. Ndryshimet e aprovuara nga Konferenca e Palëve u njoftohen Shteteve Palë nga Drejtori i Përgjithshëm. Ato hyjnë në fuqi 45 ditë pas atij njoftimi, përveç kur një Shtet Palë ka njoftuar paraprakisht Drejtorin e Përgjithshëm që ai nuk i pranon këto ndryshime.

4. Një Shtet Palë që ka njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm që ai nuk pranon një ndryshim të aprovuar në pajtim me paragrafët e mësipërm, i nënshtrohet aneksit të pandryshuar.

## VII. DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 35
### Sistemet kushtetuese federale ose jounitare

Dispozitat e mëposhtme zbatohen për Shtetet Palë që kanë një sistem kushtetues federal ose jounitar:

a) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave është nën juridiksionin ligjor të pushtetit legjislativ federal ose qendror, detyrimet e qeverisë federale ose qendrore janë të njëjta, si edhe për ato Shtete Palë që nuk janë Shtete federale;

b) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave është nën juridiksionin e shteteve përbërëse individuale, rajoneve, provincave apo kantoneve që nuk janë të detyruara nga sistemi kushtetues i federatës të ndërmarrë masa legjislative, qeveria federale informon organet kompetente të këtyre shteteve, rajoneve, provincave ose kantoneve për këto dispozita, së bashku me rekomandimet e saj për miratim.

### Neni 36
### Ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit nga Shtetet Palë, shtete të UNESCO-s në pajtim me procedurat e tyre përkatëse kushtetuese. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

### Neni 37
### Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas datës së depozitimit të instrumentit të trembëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që e shpreh më vonë pëlqimin e tij për t’iu nënshtruar asaj, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

### Neni 38
### Shtrirja territoriale e Konventës

1. Çdo shtet, në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ai është përgjegjës dhe te të cilët kjo Konventë zbatohet.

2. Çdo Shtet Palë, në një datë të mëvonshme dhe me një deklaratë drejtuar UNESCO-s, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor që përcaktohet në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas datës së marrjes së një deklarimi të tillë nga depozituesi.

3. Çdo deklaratë e bërë në pajtim me dy paragrafët e mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar UNESCO-s. Kjo tërheqje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga depozituesi.

Neni 39
**Denoncimi**

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë. Denoncimi njoftohet nëpërmjet një instrumenti me shkrim, depozituar te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati gjashtëmujor pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Ky nuk ka efekt mbi detyrimet financiare të Shtetit Palë përkatës deri në datën kur tërheqja hyn në fuqi.

Neni 40
**Depozituese**

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s është depozituesi i Konventës dhe i ndryshimeve të saj. Si depozitues, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s informon Shtetet Palë në Konventë, si dhe Shtetet e tjera Anëtare të Organizatës për:

a) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;

b) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim me nenin 37;

c) çdo raport të përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 31;

d) çdo ndryshim të Konventës ose të anekseve të miratuara në pajtim me nenet 33 dhe 34 dhe datën në të cilën ndryshimi hyn në fuqi;

e) çdo deklarim ose njoftim të bërë në bazë të dispozitave të nenit 38;

f) çdo njoftim të bërë në bazë të dispozitave të nenit 39 dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;

g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Neni 41
**Regjistrimi**

Në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

Neni 42
**Tekstet autentike**

1. Kjo Konventë, duke përfshirë edhe anekset e saj, është përpiluar në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku të gjashta tekstet janë njësoj autentike.

2. Shtesat në këtë Konventë janë në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle.

Neni 43
**Rezervat**

Nuk lejohet asnjë rezervë që nuk pajtohet me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

Aneks I – Lista e ndaluar – Standardi ndërkombëtar
Aneksi II – Standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik
Shtesa 1 – Kodi Botëror Antidoping
Shtesa 2 – Standardi ndërkombëtar për laboratorët
Shtesa 3 – Standardi ndërkombëtar për testimin
Depozitues:

**Hyrja në fuqi**

Në pajtim me nenin 37, kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas depozitimit të instrumentit të trembëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit. Për çdo shtet që e shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'iu nënshtruar asaj, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

Tekstet autentike
Në gjuhën arabe, angleze, kineze, frënge, spanjolle dhe ruse.

Shtetet Palë
Listë në rend alfabetik
Listë në rend kronologjik

Deklarata dhe rezerva
Danimarkë
Instrumenti i ratifikimit përmbante deklarimin e mëposhtëm:
"Jusqua'á décision ultérieure, la Convention ne s'appliquera pas aux îles Féroé et au Groenland. "(origjinali: frëngjisht)"

Zelanda e Re
Instrumenti i pranimit përmbante deklarimin e mëposhtëm:
"Dhe deklaron se në pajtim me statusin kushtetues të Tokelaut dhe duke marrë parasysh përkushtimin e Qeverisë së Zelandës së Re për zhvillimin e vetëqeverisjes së Tokelaut me anë të një akti të vetëvendosjes nën Kartën e Kombeve të Bashkuara, ky pranim nuk shtrihet në Tokelau përveç kur, dhe derisa nuk, paraqitet një Deklaratë nga Qeveria e Zelandës së Re te depozituesi bazuar mbi një konsultim të përshtatshëm me atë territor;" [origjinali: në anglisht].

## SHTOJCA I
## AGJENCIA BOTËRORE ANTIDOPINGU
## KODI BOTËROR ANTIDOPING
## LISTA E NDALUAR PËR VITIN 2005
## STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Teksti zyrtar i listës së ndaluar do të mbahet nga ana e Agjencisë Botërore të Antidopingut (WADA) dhe do të publikohet në anglisht dhe në frëngjisht. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet versionit anglisht me atë frëngjisht, ka përparësi versioni në gjuhën angleze.
Lista hyn në fuqi në janar 2005.

### LISTA E NDALUAR PËR VITIN 2005
### KODI BOTËROR I ANTIDOPINGUT
E vlefshme më 1 janar 2005

Përdorimi i çdo ilaçi duhet të kufizohet për indikacione të justifikuara nga ana mjekësore

### SUBSTANCA DHE METODA TË NDALUARA NË ÇDO KOHË
### (BRENDA DHE JASHTË GARAVE)

SUBSTANCA TË NDALUARA
S1. AGJENTËT ANABOLIKË
Agjentët anabolikë janë të ndaluar.
1. Steroidet Androgjene Anabolike (AAS)
a) AAS të tipit ekzogjen (me origjinë të jashtme), që përfshijnë:
18α-homo-17β-hydroxyestr-4-en-3-one; bolasterone, boldenone; boldione; calusterone; clostebol; danazol; dehydrochloromethyl-testosterone; delta1-androstene-3,17-dione; delta1-androstenediol; delta1-dihydro-testosterone; drostanolone; ethyllestrenol; fluoxymesterone; formebolone; furazabol; gestrinone; 4-hydroxytestosterone; 4-hydroxy-19-nortestosterone; mestanolone; mesterolone; metenolone; methandienone; methandriol; methyldienolone; methyltrienolone; methyltestosterone; mibolerone; nandrolone; 19-norandrostenediol; 19-norandrostenedione; norbolethone; norclostebol; norethandrolone; oxabolone; oxandrolone;

oxymesterone; oxymethelone; quinbolone; stanazolol; stenbolone; tetrahydrogestrinone; trenbolone dhe substanca të tjera me një strukturë kimike të ngjashme apo me efekte biologjike të ngjashme.

b) AAS të tipit endogjen (me origjinë të brendshme), që përfshijnë:

Androstenediol (androst-5-ene-3β, 17β –diol); androstenedione (androst-4-ene-3,17-dione); dehydroepiandrosterone (DHEA); dihydro-testosterone; testosterone si dhe metabolitet dhe izomerët e mëposhtëm: 5α -androstane-3 α,17-diol; 5α-androstane-3α, 17β-diol; 5α-androstane-3β,17α-diol; 5α-androstane-3β,17β-diol; androst-4-ene-3α,17α-diol; androst-4-ene-3α,17β-diol; androst-4-ene-3β,17α-diol; androst-5-ene-3α,17α-diol; androst-5-ene-3α,17β-diol; androst-5-ene3β,17α-diol; 4-androstenediol (androst-4-ene-3b,17β-diol); 5 androstendeione (androst-5-ene-3,17-dione); epi-dihydrotestosterone; 3α-hydroxy-5α-androstan-17-one; 3β-hydroxy-5α-androstan-17-one; 3β-hydroxy-5α-androstan-17-one; 19-norandro-sterone; 19-noretiocholanolone.

Kur një substancë e ndaluar (sipas listës më sipër) është e mundur të prodhohet nga ana e trupit në mënyrë natyrale, një mostër konsiderohet se përmban këtë substancë të ndaluar, kur përqendrimi i substancës së ndaluar ose i metaboliteve dhe treguesve të saj dhe/ose i çdo përpjesëtimi tjetër që ka lidhje në mostrën e atletit, devijon nga hapësira e vlerave që gjenden normalisht në trupin e njeriut aq sa është e pamundur të jetë në përputhje me prodhimin normal të brendshëm të trupit. Një mostër konsiderohet se nuk përmban një substancë të ndaluar në të gjitha rastet kur atleti jep prova të faktuara që përqendrimi i substancës së ndaluar, i metaboliteve apo treguesve të saj dhe/ose kur përpjesëtimet në lidhje me mostrën e atletit i atribuohen një kushti të caktuar psikologjik apo patologjik. Në të gjitha rastet dhe për çdo lloj përqendrimi, laboratori duhet të raportojë një përfundim analitik të disfavorshëm, nëse, bazuar mbi çdo metodë analitike të besueshme, ai mund të vërtetojë që substanca e ndaluar është me origjinë ekzogjene (të jashtme).

Nëse rezultati i laboratorit nuk është përfundimtar dhe nëse nuk është gjetur një përqendrim ashtu siç shprehet në paragrafin e mësipërm, organizmi përkatës antidoping duhet të kryejë një hetim të mëtejshëm, nëse ka tregues seriozë, të tilla si një krahasim me profilin e stereoidit të referencës, për një përdorim të mundshëm të substancës së ndaluar.

Nëse laboratori ka raportuar një prani në urinë të përpjesëtimit të T ndaj E më të madh se katër (4) me një (1), investigimi i mëtejshëm është i detyrueshëm për të përcaktuar, nëse ky raport është si shkak i ndonjë kushti psikologjik apo patologjik, përveçse në rastet kur laboratori raporton një përfundim analitik të disfavorshëm të bazuar në çfarëdo metode analitike të besueshme, që tregon se substanca e ndaluar është e një origjine të jashtme.

Në rast të ndonjë hetimi, ai do të përfshijë një rishikim të çdo testi të mëparshëm dhe/apo në vijim. Nëse testet e mëparshme nuk janë më të disponueshme, atleti duhet të testohet pa u njoftuar më parë, të paktën tri herë brenda një periudhe prej tre muajsh.

Nëse një atlet nuk bashkëpunon në hetimet që bëhen, mostra e atletit do të gjykohet se ka një substancë të ndaluar.

2. Agjentë të tjerë anabolikë, që përfshijnë, por që nuk kufizohen vetëm me substancat:

Clenbuterol, zeranol, zilpaterol.

Për qëllime të këtij seksioni:

*Termi “ekzogjen” i referohet një substance, e cila nuk është e mundur të prodhohet nga ana e trupit të njeriut në mënyrë natyrale.

** Termi “endogjen” i referohet një substance e cila është e mundur të prodhohet nga ana e trupit të njeriut në mënyrë natyrale.

S2. HORMONET DHE SUBSTANCAT PËRKATËSE

Substancat në vijim, përfshirë edhe substanca të tjera me një strukturë kimike të ngjashme apo me efekte biologjike të ngjashme, si dhe faktorët e tyre çlirues, janë të ndaluara:

1. Erythropoietin (EPO);

2. Hormoni i Rritjes (Hgh), faktori i rritjes i ngjashëm me insulinën (IGF-1), Faktorët e Rritjes Mekanike (MGF);

3. Gonadotrophins (LH, hCG);

4. Insulin;

5. Corticotrophins.

Përveçse në rastet kur atleti mund të demonstrojë që përqendrimi është për shkak të një kushti psikologjik ose patologjik, një mostër konsiderohet se përmban këtë substancë të ndaluar (siç tregohen më sipër) kur përqendrimi i substancës së ndaluar ose i metaboliteve dhe treguesve të saj, dhe/ose i

çdo përpjesëtimi tjetër që ka lidhje me mostrën e atletit devijon aq shumë nga hapësira e vlerave që gjenden normalisht në trupin e njeriut sa që është e pamundur të jetë në përputhje me prodhimin normal të brendshëm të tij.

Prania e substancave të tjera me një strukturë të ngjashme kimike ose me efekte biologjike të ngjashme, treguesit diagnostikues ose faktorët me efekte çliruese të një hormoni të listës së mësipërme të substancave, ose të çdo rezultati tjetër të cilat tregojnë se substanca e zbuluar është e një origjine të jashtme, do të raportohen si një përfundim analitik i disfavorshëm.

S3. AGONISTËT BETA-2

Të gjithë agonistët Beta-2, përfshirë edhe izomerët e tyre D dhe L janë të ndaluar. Përdorimi i tyre kërkon marrjen e një përjashtimi për përdorimin terapeutik të tyre.

Si përjashtim, formoteroli, salbutamoli, salmeteroli dhe terbutalina, kur administrohen nëpërmjet frymëmarrjes për të parandaluar dhe/ose mjekuar azmën, si dhe të ushtrimeve që shkaktojnë shtrëngime bronko-azmatike, kërkojnë një përjashtim për përdorimin terapeutik të përkohshëm.

Megjithë dhënien e përjashtimit për përdorimin terapeutik, kur laboratori ka raportuar një përqendrim të salbutamolit (e lirë plus glucuronide) më të madh se 1000 ng/Ml, kjo do të konsiderohet se përbën një përfundim analitik të disfavorshëm, përveç se kur atleti provon me fakte konkrete se rezultati jo normal ka ardhur si pasojë e përdorimit terapeutik të salbutamolit të marrë për frymëmarrjen.

S4. AGJENTËT ME AKTIVITET ANTIESTROGJENIK

Janë të ndaluara përdorimi i klasave të mëposhtme të substancave anti-estrogjenike:

1.7 Agjentët aromatikë frenues, që përfshijnë, por që nuk kufizohen me anastrazolin, letrozolin, aminogluthetimide, exemestane, formestane, testolactone.

2.7 Modulatorët receptorë estrogjenë selektivë (SERM), që përfshijnë, por që nuk kufizohen me raloxifen, tamoxifen, toremifen.

3.7 Substanca të tjera antiestrogjenike, që përfshijnë, por nuk kufizohen me clomiphene, cyclofenil, fulvestrant.

S5. DIURETIKËT DHE AGJENTËT E TJERË MASKUES

Diuretikët dhe agjentët e tjerë maskues janë të ndaluar.

Agjentët maskues përfshijnë, por nuk kufizohen me:

Diuretikët*, epitestosterone, probenecid, agjentët aromatikë alpha-reductase (si p.sh. finasteride, dutasteride), zgjeruesit e plazmës (p.sh. albumin, dextran, niseshte hydroxyethyl).

Diuretikët përfshijnë:

Acetazolamide, amiloide, bumetanide, canrenone, chlortalidone, acid etacrynic, furosemide, indapamide, metolazone, spironolactone, thiazides (p.sh. bendroflumethiazide, chlorothiazide, hydrochlorothiazide) triamterene dhe substanca të tjera me një strukturë kimike të ngjashme apo efekte biologjike të ngjashme.

* Një përjashtim për përdorim terapeutik nuk është i vlefshëm nëse urina e një atleti përmban një diuretik të shoqëruar me nivele të pragut ose nënpragut të lejuar të një ose disa substancave të ndaluara.

METODAT E NDALUARA

M1. SHTIMI I TRANSFERIMIT TË OKSIGJENIT

Veprimet e mëposhtme janë të ndaluara:

a) Dopingu i gjakut, përfshi përdorimin e gjakut autologous, homologous ose heterologous, ose të produkteve të rruazave të kuqe të gjakut të çdo lloj origjine, përveç se në rastet e veçanta të trajtimit mjekësor.

b) Shtimi artificial i aspirimit, transportin ose dhënien e oksigjenit, që përfshin, por nuk kufizohet me substancat perfluorochemichals, efaproxiralet (RSR13) dhe produkte të hemoglobinës së modifikuar (të tilla si zëvendësuese të gjakut bazuar mbi hemoglobinën, produkte të hemoglobinës në mikro-kapsula).

M2. MANIPULIMI KIMIK DHE FIZIK

Veprimet e mëposhtme janë të ndaluara:

Falsifikimi ose tentativat për manipulim, që kanë si qëllim ndryshimin e integritetit dhe të vlefshmërisë së mostrave që merren për kontrollet e dopingut.

Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen me infuzionet intravenoze*, aplikimin e kateterizmit (marrjen e lëngjeve të brendshme me gyp thithës) dhe zëvendësimin e urinës.

* Përveç se në rastet akute të trajtimit mjekësor legjitim, infuzionet intravenoze janë të ndaluara.

M3. DOPINGU I GENEVE

Është i ndaluar përdorimi joterapeutik i qelizave, i gjeneve, i elementeve gjenetike ose modulimi i shprehjes së gjeneve që kanë aftësinë e rritjes së performancës atletike.

SUBSTANCAT DHE METODAT E NDALUARA GJATË GARAVE

Përveç kategorive S1 deri në S5 dhe M1 deri në M3 të përcaktuara më sipër, janë të ndaluara gjatë garave edhe kategoritë e mëposhtme:

SUBSTANCAT E NDALUARA

S6. STIMULANTËT

Stimulantët e mëposhtëm janë të ndaluar, përfshi të dy izomerët e tyre optikë (D dhe L), kur janë të pranishëm:

Adrafinil, amfepramone, amiphenazole, amphetamine, amphetaminil, benzphetamine, bromantan, carphedon, cathine*, clobenzorex, cocaine, dimethylamphetamine, ephedrine**, etilamphetamine, etilefrine, famprofazone, fencamfamin, fencamine, fenetylline, fenfluramine, fenproporex, furfenorex, mefenorex, mephentermine, mesocarb, methamphetamine, methylamphetamine, methylenedioxyamphetamine, methylenedioxy-methamphetamine, methyl-ephedrine**,methylphenidate, modafinil, mikethamide, norfenfluramine, parahydroxyamphetamine, pemoline, shendi- metrazine, phenmetrazine, phentermine, prolintane, selegiline, strychnine dhe substanca të tjera me një strukturë të ngjashme kimike ose efekt (e) *** të ngjashme biologjike.

* Përdorimi i Cathine-s ndalohet kur përqendrimi në urinë është më i madh se 5 mikrogram për mililitër.

** Përdorimi i çdo lloji të ephedrine-s dhe methylephedrine-s ndalohet kur përqendrimi i saj në urinë është më i madh se 10 mikrogram për mililitër.

*** Substancat e përfshira në programin e monitorimit të vitit 2005 (bupropion, kafeina, phenylephrine, phenylpropanolamine, pipradol, pseudoephedrine, synephrine) nuk konsiderohen si substanca të ndaluara.

SHËNIM: Adrenalina e shoqëruar me agjentë të anestezisë lokale ose me përdorim lokal (për shembull hundor, oftalmologjik) nuk është e ndaluar.

S7. NARKOTIKËT

Është i ndaluar përdorimi i narkotikëve të mëposhtëm:

Buprenorphine, dextromoramide, diamorphine (heroin), fentanyl dhe derivatet e tij, hydromorphone, metadone, morphine, oxycodone, oxymorphone, pentazocine, pethidine.

S8. KANABINOIDET

Është i ndaluar përdorimi i kanabinoideve (për shembull hashashi, marijuana)

S9 GLUKOKORTIKOSTEROIDET

Ndalohet përdorimi i të gjitha glukokorticosteroideve kur përdoren nga goja, nëpërmjet zorrëve, nëpërmjet venave ose muskujve. Përdorimi i tyre bëhet vetëm me anë të miratimit të përjashtimit për përdorim terapeutik.

Të gjitha rrugët e tjera të përdorimit kërkojnë një përjashtim të shkurtuar të përdorimit terapeutik. Preparatet dermatologjike nuk janë të ndaluara.

SUBSTANCAT E NDALUARA NË SPORTE TË VEÇANTA

P1. ALKOOLI

Alkooli (ethanoli) është i ndaluar në gara vetëm në sportet e mëposhtme. Zbulimi i përdorimit të tij kryhet nëpërmjet analizës së frymëmarrjes dhe/ose gjakut. Pragu i ndaluar i dopingut për çdo federatë është dhënë si më poshtë në kllapa:

| | | |
|---|---|---|
| - Aeronautikë (FAI) | (0,20 g/L) | |
| - Loja me harqe (FITA) | (0,10 g/L) | |
| - Automobilizëm (FIA) | (0,10 g/L) | |
| - Bilardo (WCBS) | (0,20 g/L) | |
| - Boules (lojë me top)(CMSB) | (0,10 g/L) | |
| - Karate (WKF) | (0,10 g/L) | |
| - Pesëgarësh modern (UIPM) | (0,10 g/L) | për disiplinat që përfshijnë qitjen, |
| - Motoçiklizëm (FIM) | (0,00 g/L) | |
| - Ski (FIS) | (0,10 g/L) | |

P2. NEUTRALIZUESIT – BETA

Përveç se në rastet kur përcaktohet ndryshe, është i ndaluar përdorimi i neutralizuesve-Beta vetëm në sportet e mëposhtme:

- Aeronautikë (FAI),
- Loja me harqe (FITA) (i ndaluar edhe jashtë garës),
- Automobilizëm (FIA),
- Bilardo (WCBS),
- Bobsleigh (loja me rrëshqitjen e lojtarëve me slitë mbi dëborë) (FIBT),
- Boules (lojë me top) (CMSB),
- Brixh (FMB),
- Shah (FIDE),
- Curling (loja e gurëve me dorezë mbi akull) (WCF),
- Gjimnastikë (FIG),
- Motoçiklizëm (FIM),
- Pesëgarësh modern (UIPM), për disiplinat që përfshijnë qitjen,
- Bowling me 9 gurë (FIQ),
- Vozitje (ISAF) vetëm për garat e lojërave me timon drejtues,
- Qitje (ISSF) (i ndaluar gjithashtu edhe jashtë garës),
- Ski (FIS), në hedhjet me ski dhe në rrëshqitjen stil i lirë me bord mbi dëborë,
- Not (FINA) në hedhjet nga trampolina dhe notimin e sinkronizuar,
- Mundje (FILA).

Neutralizuesit-Beta përfshijnë, por nuk janë të kufizuar me sa vijon:

Acebutotol, alprenolol, atenolol, betaxolol, bisoprolol, bunolol, carteolol, carveditol, celiprolol, esmolol, labetalol, levobunolol, metipranolol, metoprolol, nadolol, oxprenolol, pindolol, propranolol, sotalol, timolol.

SUBSTANCAT E SPECIFIKUARA*

"Substancat e specifikuara"* janë listuar si më poshtë:

- ephedrine, L-methylamphetamine, methylephedrine;
- cannabinoid-et
- të gjithë agonistët Beta-2 që merren me rrugët e frymëmarrjes, me përjashtim të clenbuterol-it;
- probenecid-i;
- të gjithë Glucocorticosteroid-et
- të gjithë neutralizuesit beta;
- alkooli.

* "Lista e ndaluar mund të identifikojë substancat e specifikuara të cilat janë veçanërisht të ndjeshme ndaj shkeljeve të paqëllimshme të rregullave antidoping për shkak të disponueshmërisë së tyre në produktet medicinale, ose të cilat ka pak të ngjarë të përdoren me sukses si abuzim për agjentë dopingu." Një shkelje e dopingut që përfshin substanca të tilla mund të rezultojë në një sanksion të reduktuar me kusht që "... Atleti të saktësojë që përdorimi i një substance të tillë të specifikuar nuk ka pasur për qëllim të rrisë performancën sportive të tij…".

## SHTOJCA II
## STANDARDET PËR DHËNIEN E PËRJASHTIMIT PËR PËRDORIM TERAPEUTIK

Pjesë të nxjerra nga "Standardi ndërkombëtar për përjashtimet për përdorim terapeutik" të Agjencisë Botërore të Antidopingut (WADA), në fuqi që prej 1 janarit 2005.

4.0 Kriteret për dhënien e përjashtimit të përdorimit terapeutik

Një atleti mund t'i jepet një përjashtim për përdorim terapeutik (TUE) duke lejuar përdorimin e një substance të ndaluar ose të një metode të ndaluar të përcaktuar sipas listës së ndaluar. Një aplikim i bërë për të marrë një përjashtim për përdorim terapeutik do të shqyrtohet nga një komitet i përjashtimit për përdorim terapeutik (TUEC). Ky komitet do të caktohet nga një organizatë antidopingu. Një përjashtim për përdorim terapeutik do të jepet vetëm në përputhje të plotë me kriteret e mëposhtme:

(Koment: Ky standard është i vlefshëm për të gjithë atletët sipas përcaktimit dhe që janë

objekt i Kodit, d.m.th. atletët me aftësi fizike të shëndoshë, si dhe atletët me aftësi të kufizuar. Ky standard zbatohet sipas rrethanave përkatëse të çdo individi. Për shembull, një përjashtim që mund të bëhet për një atlet me aftësi të kufizuar mund të mos jetë i përshtatshëm për atletë të tjerë.)

5.0 Për të marrë një përjashtim për përdorim terapeutik, atleti duhet të dorëzojë një aplikim jo më pak se 21 ditë përpara pjesëmarrjes në një takim sportiv.

5.0 Atleti do të pësojë një dëmtim të jashtëzakonshëm në shëndetin e tij nëse substanca e ndaluar apo metoda e ndaluar do të mbahet e fshehur gjatë trajtimit të një kondicioni mjekësor akut apo kronik.

5.0 Përdorimi terapeutik i substancës së ndaluar ose i metodës së ndaluar mund të prodhojë një rritje shtesë të performancës, ndryshe nga ajo që mund të ishte pritur nga një kthim në gjendjen normale të shëndetit që do të vinte si rezultat i një trajtimi mjekësor të një kondicioni mjekësor të ligjshëm. Përdorimi i çdo substance të ndaluar apo metode të ndaluar për të rritur nivelet "e ulëta-normale" të një hormoni endogjen nuk konsiderohet një ndërhyrje e pranueshme terapeutike.

5.0 Nuk ka asnjë alternativë terapeutike të arsyeshme që të justifikojë përdorimin e substancave të ndaluara apo metodave të ndaluara të ndryshme.

5.0 Nevoja për përdorimin e substancave të ndaluara apo metodave të ndaluara të ndryshme nuk mund të jetë një pasojë, në tërësi ose pjesërisht, e përdorimit të mëparshëm joterapeutik të çdo substance nga lista e ndaluar.

Nëse kërkohet asistenca e ekspertëve të jashtëm të pavarur, do të qarkullohen të gjitha detajet e aplikimit pa identifikuar emrin e atletit që përfshihet në përkujdesjen e atletit. Aplikanti duhet të dorëzojë, gjithashtu një pëlqim me shkrim që vendimet e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik t'u vihen në dispozicion edhe organizatave të tjera antidoping bazuar në dispozitat e Kodit.

5.2 Anëtarët e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik dhe drejtuesit e angazhuar të Organizatës së Antidopingut do t'i kryejnë të gjitha veprimtaritë e tyre në konfidencë të plotë. Të gjithë anëtarët e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik dhe i gjithë stafi i angazhuar do të nënshkruajnë marrëveshje të konfidencialitetit. Në veçanti, ata do të mbajnë konfidencial informacionin e mëposhtëm:

a) çdo lloj informacioni dhe të dhëna mjekësore që vihen në dispozicion nga atleti dhe mjekët që angazhohen në përkujdesjen e atletit;

b) të gjitha detajet e aplikimit, përfshi emrin e mjekëve të angazhuar në proces.

Nëse atleti revokon të drejtën e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik (TUEC) ose të Agjencisë Botërore të Antidopingut (WADA) për të siguruar çdo lloj informacioni në emrin e tij/ të saj, atleti duhet që për këtë fakt të njoftojë mjekun e tij/ të saj me shkrim. Si pasojë e këtij vendimi, atleti nuk do të marrë miratim për një përjashtim për përdorim terapeutik ose për rinovim të një përjashtimi për përdorim terapeutik ekzistues.

6.0 Komitetet e përjashtimit për përdorim terapeutik (TUEC)

Komitetet TUEC do të përbëhen dhe do të veprojnë në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

6.1 Komitetet TUEC duhet të përfshijnë të paktën tre mjekë me eksperiencë në përkujdesjen dhe trajtimin e atletëve dhe me njohuri të thella në mjekësinë klinike, sportive dhe të stërvitjeve. Në mënyrë që të sigurohet një nivel i nevojshëm pavarësie në marrjen e vendimeve, pjesa më e madhe e anëtarëve të Komiteteve TUEC nuk duhet të ketë ndonjë përgjegjësi tjetër në organizatën antidoping. Të gjithë anëtarët e një Komiteti TUEC do të nënshkruajnë një marrëveshje të konfliktit të interesave. Në aplikimet që përfshijnë atletët me aftësi të kufizuara, të paktën një anëtar i Komitetit TUEC duhet të ketë eksperiencë të veçantë për përkujdesjen dhe trajtimin e atletëve me aftësi të kufizuara.

6.2 Komitetet TUEC mund të kërkojnë çfarëdolloj ekspertize shkencore ose mjekësore që ata e konsiderojnë të përshtatshme në shqyrtimin e rrethanave të çdo aplikimi për një përjashtim për përdorim terapeutik.

6.3 Komiteti TUEC i Agjencisë WADA duhet të përbëhet sipas kritereve të parashikuara në nenin 6.1. Komiteti TUEC i Agjencisë WADA është krijuar për të rishqyrtuar me iniciativën e vet vendimet e përjashtimit për përdorim terapeutik që janë dhënë nga organizatat antidoping. Ashtu siç specifikohet në nenin 4.4 të Kodit, Komiteti TUEC i Agjencisë WADA, bazuar në kërkesën e atletëve të cilëve, nuk u është miratuar përjashtimi për përdorim terapeutik nga një organizatë antidoping, ka të drejtë të rishqyrtojë këto vendime me autoritetin për t'i shfuqizuar ato.

7.0 Procesi i aplikimit të përjashtimit për përdorim terapeutik

7.1 Një përjashtim për përdorim terapeutik (TUE) do të merret në konsideratë vetëm me

marrjen e formës së aplikimit të plotësuar, e cila duhet të përfshijë të gjitha dokumentet e nevojshme (shih shtojcën 1 – formati TUE). Procesi i aplikimit duhet të trajtohet në përputhje të plotë me parimet e rrepta të konfidencialitetit mjekësor.

7.2 Formati i aplikimit TUE, siç parashikohet në shtojcën 1, mund të modifikohet nga organizatat antidoping me synimin për të përfshirë kërkesa të mëtejshme informative, por asnjë seksion ose çështje nuk duhet të hiqet.

7.3 Formati i aplikimit TUE mund të përkthehet në gjuhë të tjera nga ana e organizatave antidoping, por gjuha angleze ose frënge duhet të mbeten në formatin e aplikimit.

7.4 Një atlet nuk mund të aplikojë një TUE për më shumë se një organizatë antidopingu. Aplikimi duhet të identifikojë sportin e atletit dhe, kur është e nevojshme, disiplinën dhe pozicionin ose rolin specifik.

7.5 Aplikimi duhet të listojë ndonjë kërkesë të mëparshme ose aktuale për leje të përdorimit të një substance të ndaluar ose të një metode të ndaluar të ndryshme, organizmin të cilit i është bërë kjo kërkesë dhe vendimin e atij organizmi.

7.6 Aplikimit duhet t'i bashkëlidhet një anamnezë e plotë mjekësore dhe rezultatet e të gjitha ekzaminimeve, shqyrtimeve laboratorike dhe studimeve me imazhe që kanë lidhje me aplikimin.

7.7 Çdo shqyrtim, ekzaminim dhe studim i mëtejshëm me imazhe, që ka lidhje me rastin konkret e që kërkohet nga Komiteti TUEC i organizatës antidoping, do të merret me shpenzimet e vetë aplikantit ose të organit administrues sportiv kombëtar të tij/të saj.

7.8 Aplikimit duhet t'i bashkëlidhet një deklaratë nga një mjek i kualifikuar i fushës, që vërteton për domosdoshmërinë e substancës së ndaluar ose të metodës së ndaluar të ndryshme, në trajtimin e atletit, duke përshkruar përse një mjekim alternativ i lejuar nuk mund të përdoret ose nuk mund të ishte përdorur në trajtimin e këtij kondicioni.

7.9 Doza, shpeshtësia, rrugët e marrjes dhe kohëzgjatja e përdorimit të substancës së ndaluar ose të metodës së ndaluar të ndryshme, për të cilën bëhet fjalë duhet të specifikohen.

7.10 Vendimet e Komitetit TUEC duhet të përfundojnë brenda 30 ditësh nga data e marrjes së të gjithë dokumentacionit në fjalë dhe do t'i përcillen me shkrim atletit nga organizata e interesuar antidoping. Kur një atleti i jepet e drejta e përjashtimit për përdorim terapeutik në organin e testimit të regjistrimeve të organizatës antidoping, atletit dhe agjencisë WADA do t'u vihet menjëherë në dispozicion një fletëmiratim, i cili përfshin informacion në lidhje me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe kushte të tjera që lidhen me përjashtimin për përdorim terapeutik.

7.11 (a) Me marrjen për shqyrtim të një kërkese nga një atlet, ashtu siç specifikohet në nenin 4.4 të Kodit, Komiteti TUEC i agjencisë WADA ka autoritetin që të shfuqizojë një vendim mbi një përjashtim për përdorim terapeutik të dhënë nga një organizatë antidopingu. Atleti duhet të vërë në dispozicion të Komitetit TUEC të agjencisë WADA të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e përjashtimit për përdorim terapeutik, ashtu siç ishte paraqitur fillimisht organizatës antidoping të shoqëruar me një taksë aplikimi. Deri në përfundimin e procesit të rishqyrtimit, vendimi origjinal mbetet në fuqi. Procesi nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së informacionit nga agjencia WADA.

(b) Agjencia WADA mund të kryejë një rishqyrtim në çdo kohë. Komiteti TUEC i agjencisë WADA duhet të përfundojë rishqyrtimin e tij brenda 30 ditëve.

7.12 Nëse vendimi në lidhje me dhënien e një përjashtimi për përdorim terapeutik është shfuqizuar nga rishqyrtimi i bërë atij, anulimi i vendimit nuk ka fuqi prapavepruese dhe nuk i skualifikon rezultatet e atletit gjatë periudhës që ishte dhënë përjashtimi për përdorim terapeutik, dhe do të hyjë në fuqi jo më vonë se 14 ditë pas njoftimit të atletit për vendimin.

8.0 Procesi i aplikimit për përjashtim për përdorim terapeutik të shkurtuar (ATUE).

8.1 Është e njohur se disa substanca të përfshira në listën e substancave të ndaluara përdoren për të trajtuar kondicione mjekësore që hasen shpesh në komunitetin e atletëve. Në raste të tilla, nuk është i nevojshëm një aplikim i plotë siç përshkruhet në seksionin 4 dhe seksionin 7. Për këtë qëllim, është krijuar një proces i shkurtuar i dhënies së përjashtimit për përdorim terapeutik.

8.2 Substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara që mund të jenë të lejuara nga ky proces i shkurtuar janë tërësisht të kufizuara për sa më poshtë:

Agonistët Beta-2 (formoterol, salbutamol, salmeterol dhe terbutaline) nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes, dhe glucocorticosteroidet nëpërmjet rrugëve joorganike.

8.3 Për përdorimin e një prej substancave të mësipërme, atleti duhet të vërë në dispozicion të organizatës antidoping një njoftim mjekësor që justifikon nevojën terapeutike të përdorimit të tij. Një njoftim mjekësor i tillë, siç përcaktohet në shtojcën 2, duhet të përshkruajë diagnozën, emrin e ilaçit, dozën, rrugët e marrjes së tij dhe kohëzgjatjen e trajtimit mjekësor. Kur është e aplikueshme, çdo test i kryer për të përcaktuar diagnozën duhet të bashkëlidhet (pa ndonjë rezultat aktual ose detaje).

8.4 Procesi i shkurtuar përfshin:

a) miratimin për përdorimin e substancave të ndaluara, që janë objekt i procesit të shkurtuar, bëhet i efektshëm me marrjen e një dokumentacioni të plotë nga ana e organizatës së antidopingut. Dokumentacionet jo të plota duhet t'i rikthehen mbrapsht aplikantit;

b) me marrjen e një dokumentacioni të plotë, organizata antidoping duhet të njoftojë atletin menjëherë. Kur është e nevojshme, IF-ja, NF-ja, dhe NADO-ja e atletit duhet gjithashtu të vihen në dijeni. Organizata antidoping duhet të vërë në dijeni agjencinë WADA vetëm me marrjen e një dokumentacioni nga ana e një atleti të nivelit ndërkombëtar;

c) një dokumentacion për një ATUE nuk do të konsiderohet për miratim me veprim prapaveprues, përveçse në rastet :

- Kur është e nevojshme një trajtim emergjent ose trajtim i një kondicioni mjekësor akut; ose
- Kur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ka mundësi dhe kohë të pamjaftueshme për një aplikant për të dorëzuar një aplikim, apo për një Komitet TUEC për të marrë një aplikim përpara kontrollit të dopingut.

8.5 a) Një rishqyrtim nga ana e Komitetit TUEC ose nga Komiteti TUEC i agjencisë WADA mund të iniciohet në çdo kohë gjatë periudhës së kohëzgjatjes së një ATUE.

b) Nëse një atlet kërkon një rishqyrtim të një mohimi pasues të një ATUE, atëherë Komiteti TUEC i agjencisë WADA do të ketë autoritetin të kërkojë nga atleti informacion shtesë mjekësor, siç gjykohet e nevojshme, shpenzimet e të cilave do të mbulohen nga ana e atletit.

8.6 Një ATUE mund të pezullohet në çdo kohë nga Komiteti TUEC ose nga Komiteti TUEC i agjencisë WADA. Atleti, IF-ja e tij/ e saj dhe të gjitha organizatat e tjera të antidopingut duhet të vihen menjëherë në dijeni.

8.7 Pezullimi hyn në fuqi menjëherë pas njoftimit të atletit për vendimin. Megjithatë, atleti ka të drejtë të aplikojë për një përjashtim për përdorim terapeutik, sipas seksionit 7.

9.0 Zyra qendrore (Clearing House).

9.1 Organizatave antidoping u kërkohet të vënë në dispozicion të agjencisë WADA të gjitha përjashtimet për përdorim terapeutik, dhe gjithë dokumentacionin e tyre mbështetës, që përcaktohet sipas seksionit 7.

9.2 Për sa i përket ATUE-ve, organizatat antidoping duhet të vënë në dispozicion të agjencisë WADA aplikimet mjekësore të dorëzuara nga atletët e nivelit ndërkombëtar që përcaktohen sipas seksioni 8.4.

9.3 Zyra qendrore do të garantojë konfidencialitet maksimal të gjithë informacionit mjekësor.